



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2021:050852

Datë: 02.05.2021

Numri i dokumentit: 01754769

P.nr.100/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm-gjyqtari i vetëm gjykues Shefqet Baleci, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Elheme Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit F. B. nga Ç..., B... t, Komuna e Gllogocit, për vepër penale Lëndim i lehtë trupor, të parashikuar nga neni 185 par.1. nënpar.1.4. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe të pandehurit Xh. G. nga Ç..., Komuna e Gllogocit, për vepër penale Lëndim i rëndë trupor, të parashikuar nga neni 186 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.521/21, datë.26.03.2021, në shqyrtimin fillestar gjyqësorë publik, të mbajtur me datë 16.04.2021, në prani të Prokurorit të Shtetit Nebahate Salihu dhe të pandehurve, **me datë.16.04.2021**, mori dhe publikisht shpalli si dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: F. B., i biri i S. dhe i Sh., mbiemri i saj i vajzërisë Th., i lindur me dt... në K..., Komuna e Gllogocit, tani e ka vendbanimin në Ç..., Komuna e Gllogocit, me numër personal të letërnjoftimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i katër fëmijve, i papunë, merr ndihma sociale në shumë mujore prej 130 €, i gjendjes të dobhtë ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i gjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër për ndonjë vepër penale.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: me datë 10.02.2021, rreth orës 18:30 në rrugën "...", në oborrin e Objektivit të Banesave të Socialit, në fshatin ..., Komuna e Gllogocit, i pandehuri F. B., pas një mosmarrëveshje në këtë rast me të dëmtuarin Xh. G., për shkak të parkingut të automjetit të tij, i cili parking nuk është i rezervuar për banorë të këtij objekti, dhe kështu që gjatë fjalosjës së tyre, i pandehuri F.r B. e kishte sharë, ofenduar dhe e kishte sulmuar edhe fizikisht në këtë rast të dëmtuarin Xh. G., duke e goditur njëherë me dorë në krahun e majtë, pastaj edhe njëherë në krahun e djathtë, duke i shqyer maicën, dhe me këtë rast sipas ekspertizës mjeko ligjore të përpiluar me dt.25.02.2021, nga ana e ekspertit mjeko ligjor Dr.M. G., i kishte shkaktuar dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin, në formë të gërvishjës në krahun e majtë, me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo të mprehtë),-

-më këtë ka kryer veprë penale Lëndim i lehtë trupor, të parashikuar nga neni 185 par.1. nënpar.1.4. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

I PANDEHURUI: Xh. G., i biri i S. dhe i F., mbiemri i saj i vajzërisë C., i lindur me dt.... në G..., Komuna e Glllogocit, tani e ka vendbanimin në Ç..., e Glllogocit, me numër personal të letërnjoftimit ..., ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i dy fëmijëve, i papunë, merr ndihma sociale në shumë mujore prej 107 €, i gjendjes të dobhtë ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pagjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër për ndonjë veprë penale.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: me datë 10.02.2021, rreth orës 18:30 në rrugën "...", në oborrin e Objektivit të Banesave të Socialit, në fshatin Ç..., Komuna e Glllogocit, i pandehuri Xh. G., pas sharjëve dhe sulmit fizik, si dhe dëmtimit trupor të shkaktuar nga ana e të pandehurit F. B. dhe situatës së tensionuar mes tyre, e kishte sulmuar fizikisht në këtë rast të dëmtuarin F. B., duke e goditur një herë me grusht në fytyrë në pjesën e nofullës, ku për shkak të dëmtimit në këtë rast i dëmtuari Fatmir Balaj, kishte shkuar në QKUK në Prishtinë, për tretman mjeksor, ku i ishte nënshtuar ndërhyrjes kirurgjike, për shkak se kishte pësuar dëmtime të rënda trupore, të konstatuara në ekspertizën mjeko ligjore, të përpiluar me dt.25.02.2021, nga ana e ekspertit mjeko ligjor Dr.M.G., dhe atë në formë të thyerjes në nofullën e poshtme me ripozionim, me besueshmëri të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo të mprehtë),-

- më këtë ka kryer veprë penale Lëndim i rëndë trupor, të parashikuar nga neni 186 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj gjykata në vështtrim të neneve 4,7,17,21,38,46,47,48,49,69 dhe neneve 185 par.1. nënpar.1.4.dhe 186 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neneve 360,361,365,450 par.3. 453 par.1. dhe 463 par.2. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të dy të pandehurve iu shqiptonë:

DËNIM TË KUSHTËZUAR ME BURGË

1.-Ashtu që gjykata të pandehurit F. B. ia cakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim me burg të mos ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 2 (dy) vite, nuk kryen veprë tjetër penale.

2.-Ashtu që gjykata të pandehurit Xh. G.ia cakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim me burg të mos ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 2 (dy) vite, nuk kryen veprë tjetër penale.

Detyrohen të pandehurit F. B. dhe Xh. G., që secili veç e veç, në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë shumën prej 10 €, si dhe që secili veç e veç, në emër të paushallit gjyqësorë të paguajnë shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarrimit me dhunë.

Detyrohen të pandehurit F. B. dhe Xh. G., që secili veç e veç, për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguajnë taksën në shumë prej 30 Euro, këto në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarrimit me dhunë.

I dëmtuar lidhur me veprën e kryer penale nga i pandehuri F. B., i dëmtuari Xh. G., si dhe i dëmtuar lidhur me veprën e kryer penale nga i pandehuri X. G.i, i dëmtuari F. B., për realizimin e kërkesës pasuroro juridike, lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar me këtë veprë penale udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.521/21, datë.26.03.2021, ka akuzuar të pandehurin F.B. nga Ç..., Komuna e Gllogocit, për veprë penale Lëndim i lehtë trupor, të parashikuar nga neni 185 par.1. nënpar.1.4. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe të pandehurin Xh. G. nga Ç..., Komuna e Gllogocit, për veprë penale Lëndim i rëndë trupor, të parashikuar nga neni 186 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK),

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt.16.04.2021, ku ka ftuar Prokurorin e Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm Nebahate Salihu dhe të pandehurit, ashtu siq e parashehë neni 245 par.1. të KPP-së.

Në fillim të shqyrtimit fillestar, gjyqtari i ka udhëzuar të pandehurit për të drejtën e tyre, ashtu siq e parashehë neni 246 par.1. të KPP-se. Të pandehurit kanë deklaruar se i kanë kuptuar udhëzimet.

Gjyqtari ka çmuar se e drejta e të pandehurve në mbrojtës është respektuar dhe se Prokurori i Shtetit ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë në zbulimin e provave nga neni 244 të këtij Kodi, ashtu siq e parashehë neni 246 par.2. të KPP-së.

Në bazë të nenit 246 par.3. të KPP-së, Prokurori i Shtetit ka lexuar aktakuzën. Të pandehurit kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën. Në bazë të nenit 246 par.4. të KPP-së, pasi që gjyqtari është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, të pandehurve iu ka ofruar mundësinë të pranojnë fajsinë ose të deklarohen të pafajshëm.

Të pandehurit kanë deklaruar se e pranojnë fajsinë në tërësi në të gjitha pikat e aktakuzës, pastaj gjyqtari ka përcaktuar se: të pandehurit kuptojnë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, se pranimi bëhet vullnetarisht nga të pandehurit, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, të gjitha këto të parapara me nenin 248 par.1. të KPP-së.

Në bazë të nenit 248 par.2. të KPP-së, për vlerësimin e pranimi të fajesisë së të pandehurve, gjyqtari ka kerkuar mendimin e prokurorit të shtetit. I njëjti deklaroi se janë përmbushur kushtet nga neni 248 par.1. të të njëjtit Kod.

Në bazë të nenit 248 par.4. të KPP-së, pasi që gjyqtari u bind se janë vërtetuar faktet nga paragrafi.1. i këtij neni, mori aktvendim me të cilin e pranoi pranimin e fajesisë nga të pandehurit dhe vazhdoi me seancën për vërtetimin e fakteve relevante për shqiptimin e dënimit, para shpalljes së vendimit mbi dënimin.

Në seancën për vërtetimin e fakteve relevante për shqiptimin e dënimit, gjykata ndëgjoi palët,ku:

Prokurori i Shtetit i Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, lidhur me vërtetimin e fakteve relevante për shqiptimin e dënimit deklaroi: mbetëm pranë aktakuzës, konsiderojmë se me vet pranimin e fajesisë nga ana e të pandehurve, është në përputhje me provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, i propozojmë gjykatës që të njëjtit të i shpallë fajtorë dhe të i dënoi sipas ligjit. Me rastin e marrjes së vendimit, i propozoi gjykatës që të ketë parasysh pranimin e fajesisë nga të pandehurit.

Të pandehurit për vërtetimin e fakteve relevante për shqiptimin e dënimit deklaruan: se e kemi pranuar fajësinë, pendohemi për veprat e kryera penale, kërkojmë falje, kërkojmë nga gjykata që të na shqiptoi një dënim sa më të butë.

Duke i vlersuar me ndergjegje provat e nxjerrura ne procedurë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, në bazë të nenit 7 par.1. dhe nenit 361 të KPP-së, gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjendjen e këtillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajesisë nga ana e të pandehurve, si dhe nga provat dhe faktet që i përmbanë aktakuza.

Nisur nga këto fakte dhe prova të vërtetuara në procedurë, në veprimet e të pandehurit F. B. përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, të parashikuar nga neni 185 par.1. nënpar.1.4. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të cilën e ka kryer me dashje direkte sipas nenit 21 par.2. të KPRK-së, sepse ka qenë i vetedijshëm për veprën e vet dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj, si dhe në veprimet e të pandehurit Xh. G. përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Lëndim i rëndë trupor, të parashikuar nga neni 186 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), të cilën e ka kryer me dashje direkte sipas nenit 21 par.2. të KPRK-së, sepse ka qenë i vetedijshëm për veprën e vet dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Për këto vepra penale të pandehurit F. B. dhe Xh. G. janë shpallur fajtorë, sepse në perputhje me nenin 17 par.1. të KPRK-së thuhet se “kryesi i veprës penale është penalisht pergjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia”. Në rastin konkret të pandehurit F. B. dhe Xh. G. i kanë kryer veprat penale e lartëtheksuara, me dashje direkte sipas nenit 21 par.2. të KPRK-së, ku është paraparë sanksioni penal.

Gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të pandehurin **F. B.**, pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të pandehurin merr faktin se e ka pranuar fajësinë në tërësi, se nuk të dhëna se ndaj tij zhvillohet procedurë tjetër penale, se pendohet për veprën e kryer penale, kërkonë falje, se është kryefamiljar, mbajtës i familjës, i martuar, baba i katër fëmijve, i papunë, i gjendjes së dobtë ekonomike dhe merr ndihma sociale në shumë mujore prej 130 €, ndërsa rrethanë rënduese gjeti shkallën e lartë të dashjës nga ana e të pandehurit gjatë kryerjes së veprës penale dhe se ka të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar. Andaj edhe pse për veprën penale Lëndim i lehtë trupor, të parashikuar nga neni 185 par.1. nënpar.1.4. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), është i paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre vite, të njëjtit ia shqiptoi dënimin me kushtë, duke vlerësuar se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryej vepër penale, duke u bazuar në nenin 47 të KPRK-së, duke ia caktuar dënimin me burgë në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, dhe në të njëjtën kohë urdhëroi që ky dënim me burgë të mos ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 2 (dy) vite, nuk kryen vepër tjetër penale, me bindjen se dënimi me burgë i kushtëzuar është në përputhshmeri të plotë me shkallën e rrezikshmerisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësin penale të të pandehurit dhe se i njëjti dënim do të ndikoi që të parandaloi të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmën dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarit për dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të pandehurin **Xh. G.**, pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të pandehurin merr faktin se e ka pranuar fajësinë në tërësi, se nuk të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar, se nuk të dhëna se ndaj tij zhvillohet procedurë tjetër penale, se pendohet për veprën e kryer penale, kërkonë falje, se është kryefamiljar, mbajtës i familjës, i martuar, baba i dy fëmijve, i papunë, i gjendjes së dobtë ekonomike dhe merr ndihma sociale në shumë mujore prej 107 €, ndërsa rrethanë rënduese gjeti shkallën e lartë të dashjës nga ana e të pandehurit gjatë kryerjes së veprës penale. Andaj edhe pse për veprën penale Lëndim i rëndë trupor, të parashikuar nga neni 186 par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), është i paraparë dënimi me burgim prej gjashtë muaj e deri në pesë vite, të njëjtit ia shqiptoi dënimin me kushtë, duke vlerësuar se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryej vepër penale, duke u bazuar në nenin 47 të KPRK-së, duke ia caktuar dënimin me burgë në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, dhe në të njëjtën kohë urdhëroi që ky dënim me burgë të mos ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 2 (dy) vite, nuk

kryen veprë tjetër penale, me bindjen se dënimi me burgë i kushtëzuar është në përputhshmeri të plotë me shkallën e rrezikshmerisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësin penale të të pandehurit dhe se i njëjti dënim do të ndikoi që të parandaloi të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmën dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarit për dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e bazoi në nenin 451 par.1., nenit 453 par.1. lidhur me nenin 450 par.2. nënpar.2.1. të KPP-së, ashtu që i detyroi të pandehurit që secili veç e veç, të paguajnë shumën prej 10 €, në emër të shpenzimeve të ekspertit të mjekësisë ligjore.

Vendimin mbi paushallin gjyqësorë, gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 par.3. të KPP-së, ashtu që lartësia e paushallit gjyqësorë që secili veç e veç i pandehur, të paguajë shumën prej 30 €, u caktua duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërin e procedurës penale si dhe gjendjen financiare të të pandehurve.

Vendimin që të detyrohen të pandehurit, që secili veç e veç, për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguajnë taksën në shumë prej 30 €, gjykata e bazoi në nenin 39 par.3. nënpar.3.1. të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit (ku është paraparë se gjyqtarët me rastin e shqiptimit të sanksioneve penale për veprat penale të përcaktuar në nënparagrafët 3.1. dhe 3.2. të këtij paragrafi caktojnë edhe taksat për kompensimin e viktimave si në vijim: për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në shumë prej tredhjetë (30) €, i cili ligj me datën.28.05.2015 ka hyrë në fuqi, e për të cilin Gjykata Supreme e Kosovës me Qarkoren nr.35/2018, të dt.30.01.2018, për zbatimin e të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit ka kërkuar nga gjykatat që të zbatojnë këtë dispozitë ligjore për të e paguar taksën e lartëheksuar.

Vendimin që i dëmtuar lidhur me veprën e kryer penale nga i pandehuri F. B., i dëmtuari Xh. G., si dhe i dëmtuar lidhur me veprën e kryer penale nga i pandehuri Xh. G., i dëmtuari F. B. lidhur me kërkesën pasuroro juridike për kompensimin e dëmit të shkaktuar me këtë veprë penale të i udhëzoi në kontest civil, gjykata e bazoi në nenin 463 par.2. të KPP-së, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtë të kësaj kërkesë.

Nga e lartëheksuara është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.100/2021, datë:16.04.2021

Procesmbajtësja
Elheme Kastrati

Gj y q t a r i
Shfqet Baleci

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Në bazë të nenit 380 par.2. të KPP-së, ankesa e personit të autorizuar e paraqitur brenda afatit të caktuar si më lartë, e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit.